



VENDIM

Nr. 79, Datë 08.06.2015

**PËR
TRANSFERIMIN E LICENSËS SË TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA SHOQËRIA “UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË”
SH.A. TEK SHOQËRIA “HEC LANABREGAS” SH.A.**

Në mbështetje të neneve 9; 19 dhe 20 pika 1 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 17, të Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të plotë të pjesshëm dhe rinovimit të Liçensave, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e datës 08.06.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a., liçensuar në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike me Vendimin nr. 99, datë 13.09.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, si edhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se :

1. Aplikimi i shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a për transferimin e licensës së Tregtimit të Energjisë Elektrike, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:
 - Formatin e aplikimit sipas nenit 9, pika 1, (neni 17 pika 4 gërma “a”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Informacioni me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për transferimin e licensës. (neni 17 pika 4 gërma “b”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Vendimin me shkrim i organeve drejtuese të të liçensuarit që shprehin vullnetin për të kërkuar transferimin e licensës (neni 17 pika 4 gërma “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

2. Aplikimi i shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.a për transferimin e licensës së Tregtimit të Energjisë Elektrike, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të transferojë licensën e Tregtimit të Energjisë Elektrike, nr. 147, Seria TPV11SH miratuar me Vendimin nr. 99 datë 13.09.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nga shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a, Tiranë, tek Shoqëria “Hec Lanabregas” sh.a.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit ngarkohet për njoftimin e shoqërive Ujësjetllës Kanalizime Tiranë“ sh.a, dhe “Hec Lanabregas” sh.a për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI